- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**V ula**

**Shtojca 6**

**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**  
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).



**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

**Shtojca 7**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

## **Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos ,Loti II**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislationit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

**\*\*\*Shënim: Për kryerjen e verifikimeve përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në shtojcën 4, lutemi të plotësoni të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:**

**Emër, Atësi, Mëmësi, Mbiemër, Ditëlindje**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

## Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II

- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;
- ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, **te leshuar jo me heret se 30 dite nga data e hapjes se ofertes.**

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

**Është përshkruar në Kriteret e përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.**

### 2.2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a. Vërtetim leshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2020.

b. Xhiroja mesatare vjetore për vitin **2017, 2018 dhe 2019** duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se **1,921,267 (një milion e nëntëqind e njëzetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë)lekë (40 % e fondit limit).**

c.Kopje të certifikuar të bilancit të viteve **2017, 2018 dhe 2019** të paraqitura në autoritetin përkatës Drejtoria e Tatimeve, të konfirmuara nga ky autoritet.

### 2.3Për kapacitetin teknik:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontrata të ngjashme shërbimesh në vlerë totale prej jo më pak se 40 % e fondit limit dhe konkretisht **1,921,267 (një milion e nëntëqind e njëzetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë** të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

**Per te vertetuar pervojën e meparshme detyrimisht te paraqiten dokumentat si me poshte:**

a.Kur kontratat janë të realizuara me institucione publike ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontratën/Kontratat
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikatën/Çertifikatat e marrjes në dorezim.
6. Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion të miratuar nga investitori.

## Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh duhet te paraqitet si vijon:

- Kontrata e Bashkim Operatoresh deklaruar ne fazen e tenderimit.
- Prokura e posaçme e Bashkim Operatoresh deklaruar ne faze tenderimi.

b. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontrate/Kontratat.
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt kolaudimi objekti;
5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
6. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh te miratuara nga investitori.

1.Licence per supervizim, mbikeqyrje punimesh zbatimi ne pikat si me poshte:

<b>NP- 1: Punime gërmimi në tokë.</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NP-2: Ndërtime civile dhe industriale.</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NP-4: Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha etj.</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NP- 7: Ujësjetës, gazsjetës, vajsjetës, vepra kullimi e vaditje</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NP-11: Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, Linja të TN e të mesëm dhe shpërndarja e energjisë.</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NS-1 : Punime për prishjen e ndërtimeve</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NS-16 : Ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NS- 18 : Punime topogjeodozike</b>	<b>“Kategoria A”</b>
<b>NS -20 : Shpime gjeologo-inxhinjrike, puse e shpime për ujë</b>	<b>“Kategoria A”</b>

**Shenim:** (Si referim per rezidencen e mbikeqyresit do te merret ajo e shenuar ne QKB-ne perkatese ose ne rast te ndonje personi te autorizuar prej mbikeqyresit per ndjekjen e punimeve, do te kerkohet prokura perkatese. Ne te gjitha rastet personi i autorizuar do te jete inxhinier ndertimi.

2.Kandidati ofertues pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për realizimin me sukses të shërbimit për këtë objekt:

- *Inxhinier Ndertimi/ Hidroteknik* 2 (dy)
- *Inxhinier Gjeolog* 1 (një)
- *Inxhinier Mekanik* 1 (një)
- *Inxhinier Elektrik* 1 (një)
- *Inxhinier Gjeodet* 1 (nje)

të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome,Liçensë profesionale, CV,si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë.

## Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjiellit Qytetit Patos ,Loti II

3.Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik për mbikeqyerjen e punimeve në objekt i cili duhet të jetë (Inxhinier hidroteknik /ndërtimi), i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) CV përkatëse
- b) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- c) Diploma
- d) License profesionale

4 -Operatori Ekonomik duhet te vertetoje me Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit: Numri mesatar i punonjësve tësiguruar duhet të jetë jo më pak se **6 (gjashte) punonjës për periudhën (Shkurt 2020 – Korrik 2020).**

Per kete kriter, operatori ekonomik duhet te paraqese :

1.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **(Shkurt 2020 – Korrik 2020).**

2. Listë pagesat përkatëse, shoqëruar me Formularin E–SIG 025/a dhe formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

**Shenim:** Në përgatitjen e ofertes, ofertuesit duhet të respektojnë Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulait të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik(APP) Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, “ Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” meqellim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim.

### **Detyrat e Mbikqyresit:**

Mbikëqyrësi, përveç shërbimeve të kontrollit për zbatimin e punimeve, ndjek edhe grafikun e punimeve.

Mban dhe përgjigjet, për dokumentacionin emëposhtëm:

- a) Vendimin për sheshin ose lejen e ndërtimit dhe lejen origjinale të ndërtimit;
- b) Projektzbatimin e firmosur nga projektuesit, nga bashkia ose nga këshilli i qarkut, sipas juridiksionit.
- c) Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të themeleve, të bazamenteve dhe të punimeve të maskuara.
- ç) Dokumentacionin përkatës për të gjitha ndryshimet e mundshme që mund të jenë bërë në projekt gjatë ndërtimit të objektit, pa prekur kushtet e vëna në vendimin e KRRT-së.
- d) Planorganizimin e punimeve.
- e) Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat, sipas dispozitave në fuqi, duhet të merren para fillimit të punimeve.
- f) Verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.

**Supervizim në objektin “Rikonstruksimi i magjistratit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

g) Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe e të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.

h) Mbikëqyrësi i punimeve, harton dokumentacionin e dosjes teknike për marrjen e punimeve të kryera dhe dorëzimin e tyre tek kolaudatori.

j) Te ndjeke procedurën e dokumentimit dhe të informimit të AK nepermjet sistemit të e-lejeve.

**5.** Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se është i pajisur me Çertifikatat që vërtetojnë plotësimin e kapaciteteve të cilësisë të organizimit dhe zbatimit të standartave CE në aktivitetin e vet në lidhje me fushat mëposhtme:

- Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë **Çertifikatë ISO 9001-2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) (e vlefshme).
- Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë **Çertifikatë ISO 14001-2015** (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) (e vlefshme).
- Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë **Çertifikatë OHSAS 18001- 2007/2013** ose **ekuivalenten e saj ISO 45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ( e vlefshme)
- Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë **Çertifikatë ISO PAS 99:2012** (Për sistemin e integruar të menaxhimit) ose ekuivalente ( e vlefshme)

**6.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë detajimin e ofertës duke respektuar kriteret e V.K.M-se me nr. 354 datë 11.05.2016, si dhe duke parashikuar gjithë shpenzimet e ndjekjes së punimeve për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muajore.

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1.	Mbikëqyrje e objektit“ <b>“Rikonstruksimi i magjistratit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjetës të qytetit të Patosit, LOTI II”</b>	cope	1		
2.	Specialistët e ndarë sipas profesioneve (inxhinier ndertimi ,hidro,elektrik ,gjeodet, mekanik )	dite	624		
3.	Sigurimet Shoqërore 16.7 %	leke		0.167	
4.	Transport (rezidence-objekt – residence)	leke			
5.	Baza materiale e përdorur për dokumenta	leke			
6.	Fitimi	leke			
<b>Shuma A</b>					

**Shenim:** Në përgatitjen e ofertës, ofertuesit duhet të respektojnë Vendimin nr. 354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, “ Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim. Çdo ofertë ekonomike që rezulton jashtë kufirit minimal dhe maksimal të vlerës do të skualifikohet

**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

## **Supervizim në objektin “Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

### **Shtojca 9**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

#### **PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim:

Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër \_\_\_\_\_



**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos ,Loti II**

<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**Supervizim në objektin “Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Objekti: Supervizim në objektin “Rikonstruksioni i Magjstralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos Loti II”.**

**Afatet e ekzekutimit: për aq kohë sa do të zgjasin punimet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes dhe konkretisht 24 muaj.**

**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Me ane të këtij shërbimi operator ekonomik do të mbikeqyr kryerjen e punimeve të zbatimit për kontratën si më poshtë:

## **Supervizim në objektin “Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos ,Loti II**

### **1.Rikonstruksioni i Magjistralit Kryesor dhe Rrjetit të Brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës”**

Detyrat: Sipas akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi per mbikqyrjen e punimeve.

Shpërndarja: Sipas grafikut te punimeve te kontrates .

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Projekti ka nje shtrirje te madhe gjeografike fillon prane lumit Vjose ne te djathte te rruges nacionale Fier-Tepelene prane fshatit Varibop, ku prane lumit Vjose ndodhen puscipimet dhe stacionet e pompimit te ujit te pijeshem si dhe ne nje distance prej 200-400 m nga to do te ndertohet nje stacion qendror pompimi qe do te kete nje depo uji grumbulluese-rregulluese,nga ku nje pjese e vogel e ujit me anen e dy grupeve pompash shtytese prodhimitari sejcila 5,4m<sup>3</sup>/ore dhe 20,88m<sup>3</sup>/ore do dergojne ujin ne depot Vjose dhe Varibop 1.Pjesa me e madhe e ujit prej 780m<sup>3</sup>/ore me anen e grupit te tre el/pompave siperfaesore me prodhimitari sejcila 390 m<sup>3</sup>/ore dhe rregjim pune dy ne pune dhe nje rezerve do te dergohet ne depon Mihaj 2000m<sup>3</sup>+1000m<sup>3</sup>. Nga kjo depo nepermjet rrjetit shperndares me rrjedhje te lire dhe stacioni te vogla pompimi do te furnizohen 13 depo uji qe ndodhen ne territorin e Bashkive Patos,Fier dhe Roskovec.

### **Shtojca 12**

*[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### **NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[Vendi dhe data]

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

**Supervizim në objektin “Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos ,Loti II**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[\_\_\_\_\_]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një

**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 14**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

**Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15.**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME  
Shërbimet –Kërkesë për propozim**

**Neni 1: Qellimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.



## **Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.

## **Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjistralis kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos ,Loti II**

- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktues të

## **Supervizim në objektin “Rikonstrukcion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjiellit Qytetit Patos ,Loti II**

gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t’i kryejë Shërbimet dhe përbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
